



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Periudha Raportuese	Mars 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Zana Hoxha

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Gjatë muajit mars, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) ka pranuar rreth 252 lëndë. I gjithë stafi në këtë drejtori (edhe pse jo i mjaftueshëm), ka pasur me dhjetëra takime me qytetarë, të cilat përveç shërbimeve që kanë marrë, janë njoftuar edhe me procedura dhe me çështje të tjera sipas interesit dhe kërkesave të tyre. Përkundër transferimit në objektin e ri, stafi ka qenë mjaft aktiv dhe i përgjegjshëm në kryerjen e detyrave të ndara në muajin e mëhershëm.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Funksionimi i komisionit për subvencione;
- Organizimi i procesit dhe nominimi i kandidatëve të komisionit për zgjedhje të drejtorit të QMU-së;
- Shpallja dhe përgatitja e tenderëve për furnizim me aparaturë dhe servisim të pajisjeve në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU);
- Kycja e qendrave të Mjekësisë Familjare në rrjet të internetit.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- **Mbajtja e komisionit për intervistë të dy kandidatëve të përzgjedhur për drejtorë të Qëndresë së Mjekësisë Urgjente - (QMU);**
- **Shpallja e drejtorit të QMU-së (11.03.2016);**
- **Mbajtja e komisioneve (15,17 dhe 18 mars) për subvencione, ku janë shqyrtuar rreth 370 lëndë;**
- **Shpallja publike e tenderit “Sevisimi dhe mirëmbajta e aparaturës mjekësorë në QKMF dhe njësitë e tjera”.**

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- **Përgatitje e nevojave për tenderim: “Furnizim me aparaturë për qendrat e Mjekësisë Familjare;**
- **Përgatitja e nevojave për tenderim: “Servisimi i pajisjeve në QMU”;**
- **Përgatitja e nevojave për tenderim: “Renovimi dhe furnizimi i laboratorëve në QKMF dhe QMF të re në lagjen “Tophane”, me inventarë laboratorik dhe të tjerë;**

- Bisedimi i vazhdueshëm me Institutin e Trashëgimisë Kulturore për aprovim të projektit për renovim të objektit të Dispanserit anti-tuberkular DAT;
- Monitorimi i renovimeve në ambulanca.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese:

Fondi burimor	Të planifikuara 2016	Te shpenzuara për muajin mars 2016				Total
		Mallra shërbime	Komunali	Kapitale	Subvencione	
10	601,000	52,332.84	30,285.34			
21	250,000	6,145.10			54,780.00	
Komunali	328,000					
Subvencione	290,000					
Kapitale	1,700,000			48,944.00		
Total		58,477.94	30,285.34	48,944.00	54,780.00	192,487.28
Nr. lëndëve		31	54	2	489	576

5.1.2. Takimet me palë:

- Çdo ditë nga ora 9:00 - 16:00, DSHMS bën pranimin e palëve. Rreth **210 palë** janë pranuar, me përjashtim të palëve të pranuar nga drejtori.

5.1.3. Takimet me institucione të tjera:

- Qendrën e Telemjekësisë - për qëllime të bashkëpunimit;
- QKMF - komisione për pranim të barnave;
- Drejtorin e Shërbimeve Publike - për rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese;

- Drejtorin e Urbanizmit – projektimi dhe përgatitja e specifikave, si dhe parametat për inventar laboratorik në QKMF dhe në Qendrën e re- (l. “Tophane”);
- Drejtorin e Pronës – caktimi i lokacionit për ndërtimin e QMF-së në lagjen “Veterniku”.

5.1.4. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Harta të lokacioneve të ndryshme nga Drejtoria e Pronës.

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Të pranuar 252 lëndë, të miratuara 33 lëndë, të refuzuara 1 lëndë, në përfundim e sipër 218 lëndë (vendosja e komisionit).
- Të arkivuara 749 lëndë (janar, shkurt 2016).

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 2016	Pranuara	Miratuara	Shqyrtuara nga komisioni	Refuzuara	Hedhura pashtë	Ne përfundim e sipër	Te arkivuara
Janar							
Shkurt							
Mars	252	33	370	1	X	218	749 (Janar - shkurt)
Prill							

5.1.7. Përfitues të subvencioneve për muajin mars:

- 489 përfitues, rreth 54,780 € të paguara.

5.1.8. Takime të tjera

- Anëtare në 4 komisione për pranim të barnave për nevoja të qendrave të Mjekësisë Familjare.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Vështirësitë kryesisht janë hasur në aspektin kohor.

7. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES:

- Faza II e kyçjes së qendrave të Mjekësisë Familjare në rrjetin e internetit;
- Finalizimi i lokacionit për ndërtimin e Qendrës ditore për personat me aftësi të kufizuara;
- Finalizimi i lokacionit për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen “Veterniku”;
- Mbledhja e komisionit për shqyrtimin e kërkesave nga OJQ-të e ndryshme;
- Finalizimi dhe fillimi i renovimit të DAT-it.

9. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme